



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 128/4 Prot

Tiranë, më 25.05.2021

**V E N D I M**

Nr.58, datë 25.05.2021

**Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt verifikimin e ligjshmërisë së procesit të transferimit të përhershëm të nëpunësit \*\*\*\*\* , për shkak të ristrukturimit të institucionit.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të pikës 1, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, për trajtimin e informacionit të përcjellë nga nëpunësi \*\*\*\*\* , për shkelje të legjislacionit të shërbimit civil, gjatë kryerjes së veprimit administrativ të transferimit të përhershëm për shkak ristrukturimi,

**VËREJ SE:**

Nëpërmjet kërkesës nr. 128 prot., datë 08.02.2021, nëpunësi \*\*\*\*\* ka ngritur disa pretendime, për shkelje të legjislacionit të shërbimit civil, gjatë kryerjes së veprimit administrativ të transferimit të përhershëm për shkak të ristrukturimit dhe riorganizimit të institucionit Drejtoria Rajonale e Mjedisit Fier.

Nga verifikimi i kryer për këtë rast, rezulton se punonjësi \*\*\*\*\* , ka përfitur statusin e nëpunësit civil në pozicionin “Inspektor në Sektorin e Inspektimit Mjedisor” në Drejtorinë Rajonale të Mjedisit Fier (si pjesë e strukturës së ish ISHMPUT). Kjo marrëdhënie punësimi, ka vijuar deri në momentin e shkrirjes së ish Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Inspektoratit Shtetëror i Pyjeve, Mjedisit, Ujrave dhe Turizmit dhe riorganizimit të këtij shërbimi, nëpërmjet Vendimeve nr. 568, 569, 570 e 571, datë 17.7.2019, të Këshillit të

Ministrave “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”; “Për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”; “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve” dhe “Për Krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura”.

Në kuadër të implementimit të akteve të mësipërme, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Turizmit (ISHMPUT), kaluan në proces ristrukturimi, i cili është karakterizuar nga pakësimi i njërive organizative dhe bashkimi ose shkrirja e tyre (u shkurtua numri i Agjencive Rajonale të Mjedisit: nga 12 rajone në 4 të tilla), duke u shoqëruar kjo edhe me shkurtime të vendeve të punës (pakësim të personelit), ndryshime të përshkrimit të pozicioneve të punës dhe sidomos të kërkesave të veçanta për këto pozicione të mbetura, apo krijuar rishtas.

Ndodhur në këto kushte, Komisioni i Ristrukturimit i ngritur në këtë rast, ka analizuar e vlerësuar gjendjen dhe dokumentacionin personal të gjithë nëpunësve të strukturave të mëparshme, duke përfshirë edhe karakteristikat e nëpunësit \*\*\*\*\*; në raport me pozicionet e reja të krijuara në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastër, duke mbajtur parasysh kërkesat e përcaktuara në dispozitat e Kreut II, të vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, siç janë: a) vjetërsia e nëpunësit civil në shërbimin civil; b) vlerësimet e rezultateve në punë; c) vlerësimi i fundit që ka pasur nëpunësi në testimin për përfitimin dhe për përditësimin e njohurive shtesë dhe dispozitat e udhëzimit të DAP nr.1, datë 01.03.2016 “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”.

Më tej, Komisioni i Ristrukturimit i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, ka shqyrtuar mundësinë e sistemimit të gjithë punonjësve, duke përfshirë edhe nëpunësin në fjalë, në pozicionet e reja të krijuara, duke analizuar cilësitë personale të secilit prej tyre dhe kërkesat specifike të këtyre pozicioneve.

Duke iu referuar përshkrimeve të punës dhe kritereve të posaçme të këtyre pozicioneve, Komisioni i Ristrukturimit ka arritur në përfundimin se ekzistonte mundësia që nëpunësi \*\*\*\*\*; të sistemohej në pozicionin “Specialist në Sektorin e Administrimit të të Dhënave dhe Përpunimit të Informacionit”, në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastër, pasi ishte një pozicion i të njejtës kategori me pozicionin e mëparshëm të mbajtur prej tij, për të cilin nëpunësi plotësonte kërkesat e veçanta dhe për këtë, me vendimin nr. 4619 prot., datë 10.09.2020, ka propozuar transferimin e tij në pozicionin e mësipërm.

Nisur nga fakti se ndërkohë punonjësi ishte jashtë shtetit, njësia e burimeve njerëzore të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, i ka dërguar nëpunësit \*\*\*\*\* njoftimin dhe aktin e ri të emërimit nr. 4193/12 prot., datë 14.09.2020 “Transferim për shkak të ristrukturimit

*të institucionit”, veprim administrativ të cilin nëpunësi e ka pranuar duke filluar punën në pozicionin “Specialist në Sektorin e Administrimit të të Dhënave dhe Përpunimit të Informacionit”, në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastrë.*

Për sa më sipër, konstatohet se, veprimet e kryera nga Komisioni i Ristrukturimit dhe njësia përgjegjëse, janë në përputhje me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil dhe kompetencat e tyre duke realizuar sistemimin e nëpunësit në fjalë, në një pozicion pjesë e shërbimit civil, në të njëjtën kategori me pozicionin e mëparshëm.

#### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, si dhe në nenin 34, pika 1, të të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e hetimit administrativ, me objekt verifikimin e ligjshmërisë së aktit të transferimit të përhershëm për shkak ristrukturimi, të nëpunësit \*\*\*\*\* dhe meqënëse nuk u gjenden elementë paligjshmërie, arkivimin e çështjes.
2. Të njoftohet për këtë vendim Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, si dhe nëpunësi \*\*\*\*\*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**